



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:084806  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05707973

KPPP.nr.1033/23

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike civile të kreditorit Banka për Biznes (BPB) me seli në Prishtinë, me adresë në Rr. ‘UÇK’ Nr.41, të cilën e përfaqëson ‘Debt Loan Recovery’, kundër debitorëve NTP ‘Getoar-AG’, me numër të biznesit 80284098, e të cilin e përfaqëson A.M., me vendbanim në Gjakovë dhe N.M., në cilësinë e bashkë kredi marrësit me vendbanim në Gjakovë, për shkak propozimit për përmbarrim në vlerën e borxhit prej 29,168.99€, jashtë seancës më 20.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.KONSTATOHET I TERHEQUR propozimi për përmbarrim i kreditorit Banka për Biznes (BPB) me seli në Prishtinë, me adresë në Rr. ‘UÇK’ Nr.41, të cilën e përfaqëson ‘Debt Loan Recovery’ me seli në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Përmbarruesi Privat Gëzim Gjoshi, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, ka caktuar urdhrin përmbarrimor me numër P.nr.05/17 lidhur me përmbarrimin e borxhit lëndor sipas

Aktvendimit EKZ.Nr.696/12, të datës 24.07.2016 të dhënë nga Gjykata Komunale në Gjakovë, në shumën prej 29,168.99€, Konkluzionit me numër P.Nr.05/17, i datës 30.03.2027, lëshuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi dhe Aktvendimit me numër PPP.Nr.32/17, i datës 29.06.2017 me të cilin është caktuar edhe zbatimi i përmbarimit në paluajtshmëritë e debitorit dhe me të njëjtin është kërkuar nga Zyra Komunale e Kadastrit në Gjakovë shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, gjegjësisht regjistrimi i hipotekës në emër të kreditori Banka për Biznes, me seli në Prishtinë.

Me datën 15.05.2024 i autorizuari i kreditorit pranë kësaj gjykate në formë të shkruar ka paraqitur parashtrësë me anë të së cilës ka njoftuar gjykatën se palët ndërgjyqëse me datën 14.05.2024 kanë lidhur marrëveshje në mes tyre andaj edhe si rrjedhojë ka tërhequr propozimin për përmbarim në përputhje të plotë me dispozitat për Procedurën Përmbarimore.

Andaj, gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 42 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore e lidhur me nenin 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës me datën 27.03.2024 ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi pala propozuese nuk ka prezantuar në seancë.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1033/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari:

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.